REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
KOMISIONI I PËRHERSHËM I SHQYRTIMIT TË ANKIMEVE

Nr. 5453/8 prot. Tiranë, më 20. 11. 2023

Lënda: Dërgohet për shpallje publike

Z. GERALD VILAS

Adresa Nr.1: Durrës, Autoriteti Portual, Kalata e peshkimit

Adresa Nr.2: Rruga "Rinia", Ndërtesa 23, Hyrje 6, Ap.1, Maliq

Në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Pjesa e VII, Neni 162, si dhe pas shkresës Nr. 5308/10, datë 5.10.2023, shkresës Nr. 5421/7, datë 11.10.2023, dërguar z. Gerald Vilas nga Komisioni i Përhershëm i Shqyrtimit të Ankimeve në adresën e deklaruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Adresa: Durrës, Autoriteti Portual, Kalata e peshkimit, si dhe shkresës Nr. 5453/4, datë 13.11.2023 në adresën e dhënë nga Drejtoria e Dokumenteve Biometrike dhe Shërbimeve, tentuar për tu dorëzuar me anë të njoftimit formal, Komisioni i Përhershëm i Shqyrtimit të Ankimeve pasi nuk arriti njoftimin, vendosi njoftimin publik të z. Gerald Vilas, si më poshtë vijon:

Në mbështetje të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit 64/2012 "Për peshkimin", Urdhrit nr.149, datë 31.03.2022, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zbatimin e ligjit nr. 64, datë 31.5.2012 "Për Peshkimin", ju bëjmë me dije se Komisioni i Përhershëm i Shqyrtimit të Ankimeve ka vendosur tju lerë një afat 10 ditor nga marrja dijeni e këtij njoftimi për pagesën e taksës vjetore, afat që nëse nuk respektohet con në humbjen e vlefshmerisë së lejës së peshkimit Nr. LC-6922-06-2021, datë 14.6.2021.

Sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Pjesa e VII, Neni 162 pika 3, bëjmë me dije se ky njoftim përveç se në këndin e njoftimit në ambientet e Njësisë Administrative Nr.1, Durrës, ku z. Vilas ka deklaruar aktivitetin e peshkimit, Bashkisë Maliq, ku rezulton me vendbanim, gjendet edhe në këndin e njoftimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe në faqen zyrtare "bujqësia.gov.al".

Njoftimi shpallet në datën 23.11.2023 dhe hiqet më datë 4.12.2023.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Kryetari i Komisionit

Roland Kristo